

Fjala e redaksisë

Të nderuar lexues, kolegë kudo jeni Ju përshëndesim. Po e shihni edhe Ju vet si po ikin ditët. Edhe një shtator ja behu e nga ne pritët të vazhdojmë me përkushtim në edukimin dhe arsimimin e brezave. Ne si dhuratë për punën tuaj dhe misionin e madh në shërbim të arsimit po Ju sjellim numrin 4 të

gazetës sonë të përbashkët "Arsimimi sot". Po mundohemi të jemi pranë Jush e me Ju nga numri në numër. Presim tani e tutje idetë e propozimet Tuaja kolegë të nderuar mësimdhënës kudo jeni në Kosovë. Presim edhe shkrimet Tuaja që do t'i botojmë pa tjetër. Bashkë ia qëllojmë më shumë dhe bëhemi edhe më atraktiv, e gazeta jonë bëhet më e lexuar. Urime edhe një herë viti i ri shkollor dhe po Ju lusim edhe një herë ta lexojmë e ta punojmë bashkë gazetën tonë që është njëra nga mënyrat e mira të komunikimit e të bashkëpunimit në shërbim ta unitetit tonë sindikal, në shërbim të arsimit kudo në Kosovë.

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut shpreson se viti i ri shkollor do të nis mbarë

Pasi që është afër fillimi i vitit të ri shkollor 2014/2015, Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka mbajtur takimin e radhës për të debatuar për çështje që lidhen me aktivitetet sindikale dhe me situatën momentale në Arsimin Parauniversitar të Kosovës.

Pikë qendrore e diskutimit në këtë takim ishte çështja e mësimdhënësve që vitin e kaluar shkollor kanë qenë të angazhuar me punë në vitet e 13-ta.

Kryetarët e Kuvendeve Komunale të Sindikatave të Arsimit Parauniversitar kanë raportuar lidhur me këtë çështje dhe është thënë se angazhimi i përbashkët i SBASHK-ut, MASHT-it dhe DKA-ve për të bërë një zgjidhje të pranueshme për këta mësimdhënës ka dhënë rezultate të dukshme.

U tha se janë sistemuar pjesa më e madhe e tyre. Mirëpo, nga raportimi vërehet se ende nuk

është kryer tërësisht kjo çështje në Prishtinë sepse mbetet të sistemohen edhe 13 mësimdhënës, në Viti 5 mësimdhënës, Ferizaj po ashtu 5, Shtime 2.

Këta mësimdhënës janë kryesisht të profileve profesionale si ekonomistë, inxhinier dhe të drejttimeve të bujqësisë. Gjendje më alarmante është prezantuar në shkollat e mesme në Skenderaj.


Është thënë se janë evidentuar 28 mësimdhënës për të cilët duhet të mendohet lidhur me sistemimin e tyre dhe kjo gjë pritët të bëhet në ditët në vijim duke pritur që çështja të zgjidhet për pjesën dërmuese të tyre.

Këshilli Drejtues është pajtuar që t'a përcjell situatën dhe varësisht nga ajo edhe do të reagojë me mjete sindikale.

Këshilli Drejtues ka diskutuar edhe për çështje të tjera dhe ka aprovuar bashkërisht ide dhe detyra konkrete për angazhimet në vijim.



Implemented by:



1



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Vazhdohet me Marrëveshjet në shërbim të mësimdhënësve sindikalistë

Edhe në Suharekë është duke u zhvilluar një aktivitet i vazhdueshëm në vazhden e angazhimeve të SBASHK-ut për të arritur marrëveshje me Hotele, Institucione Shëndetësore dhe Firma të Tregtisë. I merituar për këtë është kryetari i SAF dhe SAM në këtë Komunë, z. Sadik Shala, i cili ka nënshkruar duke nënshkruar dy marrëveshje me institucione private shëndetësore.

Kryetari Sadik Shala lavdëron drejtuesit e këtyre institucioneve për mirëkuptimin dhe respektin që ata kanë

shprehur për mësimdhënësit e Suharekës duke nënshkruar këto kontrata, të cilat ua mundësojnë anëtarëve të SBASHK-ut nga kjo Komunë dhe familjarëve të tyre shfrytëzimin e shërbimeve këtu me zbritjen prej 20 %. SBASHK-u falënderon gjithë njerëzit e vullnetit të mirëpër veprimin e tyre human dhe prët që ashtu si në Prishtinë, Viti, Gjilan, Suharekë, Lipjan... të vazhdohet me nënshkrime marrëveshjesh edhe në komunat tjera.

Një delegacion i SBASHK-ut viziton DKA-në e Prishtinës

Me qëllim të krijimit të një atmosfere korrekte të bashkëpunimit në SBASHK-ut i përbërë nga kryetari z.Rahman Jasharaj dhe kryetari i Kuvendit të Sindikatave të Arsimit Fillor e të Mesëm të Prishtinës, z. Ahmet Pllana kanë vizituar DKA-në e

Prishtinës dhe janë takuar me të parën e këtij Drejtorati, znj. Arbërie Nagavci. Takimi ishte i karakterit njohës dhe fillimisht delegacioni i SBASHK-ut i ka uruar suksese znj.Nagavci në angazhimet në shërbim të arsimit në kryeqytet. Pas kësaj është debatuar për shumë çështje dhe ishte zotim i dyanshëm për një bashkëpunim të vazhdueshëm në përpjekje për t'i shërbyer arsimit në Komunën e Prishtinës dhe gjithë të punësuarve në këtë segment të rëndësishëm së veçantë. Ishte mendim i përbashkët se takimet e tilla duhet vazhduar edhe në të ardhmen dhe jo vetëm në Prishtinë, po në të gjitha Komunat e Kosovës.

Në përpjekje për të bërë një vlerësim korrekt të angazhimeve të SBASHK-ut

SBASHK-u i përkrahur nga KEC -i dhe Këshilli i Evropës e në bashkëpunim të ngushtë me mikun e vjetër, ekspertin z.Osman Buleshka, është në përgatitjet finale për të nisur një komunikim të veçantë me anëtarësinë e me qëllim të një vlerësimi të angazhimeve, arritjeve, lëshimeve dhe detyrave konkrete të SBASHK-ut. Ky hulumtim do të bazohet në kriteret më të avancuara dhe do të përfshijë udhëheqës komunal sindikalë, anëtarë të Kryesive të Kuvendeve të SAF e SAM dhe mësimdhënës sindikalistë nga e tërë Kosova. Ky hulumtim do të komunikojë me 300 anëtarë të SBASHK-ut, të cilët në mënyrë anonime do të


përgjigjen në pyetjet e formuluar të cilat pastaj me një program të veçantë do të sistemohen dhe do të japin një vlerësim që do të jetë bazë e mirë për të parë se çfarë mendohet për këtë Sindikatë dhe se çfarë duhet të bëjë Kryesia dhe organet tjera të SBASHK-ut për të qenë edhe më të suksesshëm. Z.Buleshka dhe SBASHK-u janë të sigurt se të anketuarit do të bashkëpunojnë me të dhe me dy përfaqësues të emëruar nga Këshilli Drejtues dhe se ky hulumtim do të mundësojë një vlerësim korrekt për SBASHK-un.

Tani do të jemi edhe më afër Jush

Dikush ishte thënë se ka ende për t'u bërë në SBASHK në mënyrë që të përmirësohet komunikimi dhe informimi i anëtarëve dhe opinionit në tërësi për angazhimet dhe për gjithë çështjet me rëndësi. Me përpjekje të përbashkëta janë bërë arritje dhe nuk jemi të panjohur për opinionin, por ne nuk do të ndalemë me kaq. SBASHK-u në bashkëpunim me ekspertin për mediet z.Alban Zeneli do të angazhohet për vënien në jetë të një Projekti që mundëson krijimin e parakushteve për një informim edhe më të shpejtë e më cilësor. Ueb faqja me dizajn të ri, që mbështetet nga KEC-i dhe Këshilli i Evropës, rrjetet sociale, gazeta elektronike, takimet dhe bashkëbisedat me anëtarët kudo në shkollat e Kosovës, fletëpalosjet, dërgimi i informacioneve përmes adresave të shumta elektronike, konferencat për mediat dhe komunikatat, do të jenë mundësi të vazhdueshme për komunikim dhe prezantim të arritjeve dhe risive, por edhe të sfidave e shqetësimeve të SBASHK-ut. Kolegë të nderuar sindikalistë, mbështetës dhe ju miq të SBASHK-ut tani e tutje do të jemi edhe më afër Jush. Ju premtojmë se do të jemi korrekt dhe të saktë.



Implemented by:



2



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Duke u përgatitur për angazhime të reja

Me qëllim të forcimit të rolit të Sindikatës në negociim dhe në angazhimet tjera në shërbim të anëtarësisë Këshilli i Evropës përmes KEC-it e në bashkëpunim me SBASHK-un po vazhdojnë se realizuari Projektin dy vjeçar, i cili nxjerr shumë detyra e angazhime konkrete. Krahas krijimit të mundësive e mekanizmeve të shumtë për informim e komunikim me anëtarësinë dhe palët tjera, ky projekt ka synim edhe trajnimin dhe përgatitjen e sindikalistëve në shumë sfera me interes. Fillimisht janë duke u bërë seminare e trajnime për të përgatitur kuadro e pastaj ky aktivitet do të shtrihet kudo në shkollat dhe komunikatat të Strategji të veprimit dhe angazhimeve konkrete. Ky porozim i Haxhiut është kthyer në detyrë të Kryesisë dhe shpejt do të punohet një agjendë e vizitave nëpër komuna dhe gjithë anëtarësia e SBASHK-ut do të jetë e njoftuar për këtë.

zëdhënësit të SBASHK-ut dhe të njeriut të përgatitur për të komunikuar drejt e saktë me anëtarësinë, por edhe me gjithë të tjerët. Mbaxe lexuesi do të thotë pse gjithë këto angazhime rreth informimit e komunikimit, por kjo ka dalë nga një vlerësim paraprak që i është bërë SBASHK-ut dhe arritjeve e sfidave këtu. Është parë si shumë me rëndësi që të krijohen mundësi të reja e me njerëz të përgatitur në mënyrë që informacionit për dhe rreth SBASHK-ut të plasohen drejt e me kohë për secilin anëtar dhe për gjithë të interesuarit tjerë. SBASHK-u ka krijuar marrëdhënie korrekte me mediet dhe këto marrëdhënie do t'i forcojë duke dhënë shembull të mirë të korrektësisë, saktësisë dhe të transparencës.



Na gëzon bashkëbiseda me Ju

Kolegë dhe lexues të nderuar kemi vërejtur se angazhimet dhe aktivitetet e përditshme të SBASHK-ut janë duke u përcjellë me vëmendje, jo vetëm nga sindikalistët, por edhe nga opinionin i gjerë. Është dëshirë jona që ky bashkëpunim e komunikim të zgjerohet edhe shumë më shumë duke bashkëbisedat e duke u këshilluar bashkë jemi me të fortë e më të ditur. Në numrin 4 të gazetës sonë elektronike do të veçojmë një letër të kryetarit të Shoqatës Sindikale të Shkollës "Habib Berisha" nga Gurabardhi i Malishevës. Kolegu ynë Haxhiu na përgëzoi për angazhimet dhe lavdëron SBASHK-un për arritjet konkrete. Ai në letrën e tij ka edhe një propozim që është edhe detyrë e SBASHK-ut. Haxhiu kërkon që Kryesia e SBASHK-ut të jetë edhe më shumë në terren dhe të bashkëbisedojë me anëtarësinë kudo në Kosovë me qëllim që bashkërisht të përgatitin një Strategji të veprimit dhe angazhimeve konkrete. Ky porozim i Haxhiut është kthyer në detyrë të Kryesisë dhe shpejt do të punohet një agjendë e vizitave nëpër komuna dhe gjithë anëtarësia e SBASHK-ut do të jetë e njoftuar për këtë.




Ne ju ftojme edhe një herë që të vazhdoni të komunikoni me ne. Nga shtatori do ta keni edhe më lehtë sepse nis punë me pamje të re ueb faqja e SBASHK-ut duke ju dhënë mundësi të komunikimit aktiv.



Lexojni gazetën tonë elektronike dhe ta shkruani sepse kështu na ndihmoni të jemi edhe më të organizuar dhe më aktiv.

Implemented by:



3

